

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Muhoplus shpk

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 dhjetor 2019)

“MUHOPLUS” ShPK

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

(te Ushtrimit te mbyllur me date 31.12. 2019)

08 Prill 2020

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Muhoplus shpk

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 dhjetor 2019)

1. Informacion i përgjithshëm.

“MuhoPlus” shpk është shoqëri me përgjegjesi të kufizuar, themeluar date 16.11.2015, me ortak të vetëm z. Shyqyri Muho, është rregjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tirane, me nipt L52317046G.

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet sipas dispozitave të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, nga statuti dhe Legjislacioni në fuqi.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë “MuhoPlus” shpk është: Tregtimi i të gjitha llojeve të mallrave, materialeve, automjeteve me goma dhe zinxhira të tipeve të ndryshme, makinerive, pajisjeve dhe impjanteve të ndryshme të karakterit publik, industrial, bujqësor, tregtar, kulturor, sportiv.

Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë është zj. Aferdita Muho.

Selia e Shoqërisë është në Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga: Ded Gjo Luli, Pallati Nr.2, Shkalla 2, Ap.4.Tirane.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin Nr. 25/2018, date 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi


Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Leke, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve të detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Muhoplus shpk

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 dhjetor 2019)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

1. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

1.1 Transaksionet në monedhë të huaj.

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit

2019

2018



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Muhoplus shpk

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 dhjetor 2019)

Euro/LEK	121.77	123.42
USD/LEK	108.64	107.82

1.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

- **Mjetet monetare**

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

- **Llogari të arkëtueshme**

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.


- **Llogari të pagueshme**

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

- **Hua të marra dhe të dhëna**

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

- **Vlera e drejtë**



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Muhoplus shpk

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 dhjetor 2019)

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

- Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

- Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

1.3 Inventarët


Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

1.4 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Muhoplus shpk

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 dhjetor 2019)

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Makineri e pajisje	Vlera e mbetur	20 %
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20 %
Paj, zyre e informat	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5 Të ardhurat


Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Muhoplus shpk

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 dhjetor 2019)

pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 20.5% (2018: 9.4%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12 Provizionet



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Muhoplus shpk

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 dhjetor 2019)

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13 Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Postet e bilancit paraqiten:

Aktive monetare per 1.060.267 leke paraqesin mjete monetare ne banka.

Shoqeria operon me disa banka, te gjitha veprimet jane rregjistruar ne ditaret perkates, me llogarite ne valute veprimet jane kryer me kursin ditor te bankes, ndersa gjendja e monedhave te huaja ne fund te ushtrimit eshte vleresuar me kursin e Bankes se Shqiperise me date 31 dhjetor 2019, duke kaluar sipas rastit ne llogarite e shpenzimeve apo te ardhurave diferencat e kembimit.

Te drejta te arketueshme në vlerën 243.220.415 leke perfaqesojne:

Nga aktiviteti i shfrytezimit ne shumen 44.452.553 leke, paraqet llogarine Kliente per vleren e faturave te paarketuara. Kjo llogari eshte e analizuar sipas klienteve dhe rakordon me llogarine sintetike te tyre.

Te tjera te drejta te arketueshme ne shumen 198.767.862 leke paraqesin:

Tatim Fitimi per 1.371.333 leke.

Te tjera te drejta ne shumen 197.396.529 paraqesin detyrim te te treteve ndaj shoqerise.

Parapagime per inventar ne shumen 1.360.228 leke paraqet parapagime per blerje mallrash nga furnitore vendas.

Aktive afatgjata materiale

Shoqeria ka nje vlere neto aktivesh afatgjata materjale per 5.162.351 leke.

Aam gjate ushtrimit jane shtuar me 28.333 leke ne zerin pajisje pune.

Amortizimi eshte llogaritur ne shumen 1.283.504 leke, shuma e tij nuk kalon kufijte fiskal.



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Muhoplus shpk

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 dhjetor 2019)

DETYRIMET DHE KAPITALI

Kapitalet e veta paraqiten me vlere 30.343.803 leke.

Kapitali i nenshkruar i shoqerise eshte 4.000.000 leke, kapitali perbehet nga nje kuote me vlere 4.000.000 leke e cila zoterohet nga z. Shyqyri Muho.

Rezerva ligjore ne shumen 4.006.579 leke e pandryshuar nga viti kaluar.

Rezerva te tjera ne shumen 6.125.004 leke eshte pakesuar me 60.000.000 leke e cila eshte shperndare si dividend sipas vendimeve te asamblese se ortakeve date 18.01.2019 ne shumen 30.000.000 leke, date 11.06.2019 ne shumen 10.000.000 leke dhe ne daten 31.08.2019 ne shumen 20.000.000 leke. Po keshtu asambleja e ortakeve ka marre vendim per shperndarjen e fitimit 2018 ne shumen 8.764.090 leke.

Fitimi i ushtrimit sipas bilancit kontabel paraqitet per 16.212.220 leke.

Detyrimet

Detyrimet me vlere 220.459.458 leke paraqesin:

	<u>Viti 2019</u>	<u>Viti 2018</u>
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	130.981.109	132.557.999
Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore	5.669.625	3.793.820
Detyrime tatimore	42.671	75.551
Te tjera detyrime	83.766.053	44.672.918
Totali	220.459.458	181.100.288

Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit per 130.981.109 leke paraqesin llogarine furnitore per vleren e faturave te palikujduara, kjo llogari eshte e analizuar sipas furnitoreve dhe rakordon me llogarinë sintetike të tyre.

Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore paraqet detyrimin e shoqerise per pagat e punonjesve ne shumen 5.642.615 leke dhe detyrim ndaj sigurimeve per muajin dhjetor 2019 ne shumen 27.010 leke.

Detyrimet tatimore paraqesin:

- ***Tatimi mbi te ardhurat*** per 2.600 leke, detyrim per muajin dhjetor 2019.
- ***Tvsh*** per 40.071 leke.


Te tjera detyrime per 83.766.053 leke paraqet detyrim te shoqerise ndaj te treteve per borxhe te marra ne individe dhe shoqeri.

Verifikimi i llogarise Fitim Humbje

Shpenzimet dhe te ardhurat jane grupuar si me poshte:

Te ardhura

Nga shitja e mallrave e sherbimeve



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Muhoplus shpk

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 dhjetor 2019)

<i>Totali (Afarizmi)</i>	78.339.506	93.842.000
Materiale te konsumuara	54.180.295	77.455.843
Kosto e punes	2.978.503	2.982.852
Pagat e personelit	2.552.274	2.556.000
Shpenzimet per sigurime	426.229	426.852
Amortizimi	1.283.504	1.584.637
Shpenzime te tjera	1.416.640	1.548.806
Totali i shpenzimeve	59.858.942	83.572.138
Te ardhura nga interesi		4.315
Te ardhura nga kursi kembimit	594.716	42.370
<i>Fitimi Bruto</i>	19.075.280	10.316.547
Tatim fitimi	2.863.060	1.552.457
<i>Fitimi Neto (bilanci)</i>	16.212.220	8.764.090

Shpenzimet jane 59.858.942 leke ndersa te ardhurat 78.934.222 leke. Rezultati ushtrimor neto qe shoqeria ka realizuar nga veprimtaria e saj eshte fitim 16.212.220 leke. Ne te ardhurat e shoqerise jane perfshire edhe te ardhurat nga diferencat pozitive te kembimit ne shumen 594.716 leke. Faturat tatimore jane rregjistruar dhe kontabilizuar korrekt ne llogarite perkatese.

Shpenzimet jane 59.858.942 leke. Me konkretisht shpenzimet sipas zerave paraqiten:

Shpenzime per mallra 54.180.295 leke, jane perdorur per veprimtarine kryesore te shoqerise, keto shpenzime jane te justifikuara me dokumenta.

Personeli, ne kete llogari jane pasqyruar shpenzimet per paga 2.552.274 leke, sigurime shoqerore 426.229 leke, listepagesat jane perpiluar sakte dhe shpenzimet per paga e sigurime jane vendosur korrekt ne kete llogari. Nje permbledhese e pagave paraqitet :

muajt	pb bruto	pg per efekt kontribut	punedhen esi	punemarresi	sig shendets ore	total sigurime	Totali	nr punetor eve	tapi
janar	245,455	245,455	36,818	23,318	8,345	68,481	71,081	9	2,600
shkurt	262,000	262,000	39,300	24,890	8,908	73,098	75,698	9	2,600
mars	254,910	254,910	38,237	24,216	8,667	71,120	73,720	9	2,600
prill	236,000	236,000	35,400	22,420	8,024	65,844	68,444	9	2,600
maj	227,727	227,727	34,159	21,634	7,743	63,536	66,136	9	2,600
qershor	210,000	210,000	31,500	19,950	7,140	58,590	61,190	7	2,600
korrik	210,000	210,000	31,500	19,950	7,140	58,590	61,190	7	2,600
gusht	210,000	210,000	31,500	19,950	7,140	58,590	61,190	7	2,600
shtator	210,000	210,000	31,500	19,950	7,140	58,590	61,190	7	2,600
tetor	219,000	219,000	32,850	20,805	7,446	61,101	64,351	7	3,250
nentor	135,182	135,182	20,277	12,842	4,596	37,715	40,315	5	2,600
dhjetor	132,000	132,000	19,800	12,540	4,488	36,828	39,428	4	2,600
Totali	2,552,274	2,552,274	382,841	242,465	86,777	712,083	743,933	7	31,850

Amortizimi ne shumen 1.283.504 leke.

Shpenzime te tjera per 1.416.640 leke paraqesin:

- shpenzime per siguracione ne shumen 50.575 leke.



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Muhoplus shpk

(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 dhjetor 2019)

- shpenzime per energji 18.064 leke,
- shpenzime mirembajtje 170.010 leke,
- shpenzime udhetimi e djeta 301.535 leke,
- shpenzime komisioni banke 130.984 leke,
- shpenzime taksa lokale dhe mjete ne shumen 208.603 leke,
- shpenzime gjoba ne shumen 11.787 leke,
- shpenzime telefoni ne shumen 149.973 leke,
- subvencione te dhena ne shumen 50.000 leke,
- shpenzime transporti ne shumen 85.362 leke,
- shpenzime te tjera ne shumen 239.747 leke (hartim pasyra, sherbime doganore, certifikata etj.).

Rezultati ushtrimor neto qe shoqeria ka realizuar nga veprimtaria e saj eshte fitim 16.212.220 leke.

Çeshtje gjyqesore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2019 Shoqeria nuk ka asnjë çështje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, qe mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

1. Ngjarje pas datës së Bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Administratore
Aferdita Muho

